

KËRKESË
Nr. 1676, datë 26.7.2024

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT
PËR AUTORIZIMIN E OJF-ve QË DO TË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE
PARËSORE TË GARANTUAR NGA SHTETI**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në bazë të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, bën publik njoftimin si më poshtë:

Të gjitha organizatat jofitimprurëse që janë të interesuara të aplikojnë për të marrë autorizim nga ministri i Drejtësisë për të ofruar ndihmën juridike parësore duhet të plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Procedura dhe dërgimi i dokumentacionit

Dokumentacioni që duhet të depozitohet nga organizatat jofitimprurëse (OJF), për aplikim, për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:

- a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
- b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike;
- c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:
 - i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
 - ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare;
 - iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
 - iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;
- ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) lista e anëtarëve të organeve vendimmarrëse/drejtuese/ekzekutive, si dhe përfaqësuesin ligjor të organizatës jofitimprurëse (i përditësuar).
- e) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
- ë) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv;
- f) adresën elektronike të komunikimit.

Aplikimi për autorizim, i shoqëruar me dokumentacionin e sipërpërmendur, dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në adresën: rruga “Jordan Misja”, godina nr. 3, Njësia Bashkiake nr. 9, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e publikimit të njoftimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare (QBZ).

Dokumentet e sipërcituara duhet të jenë origjinale ose të njësuara me origjinalin. Aplikimet e paraqitura jashtë afatit dhe/ose jo në formatin e kërkuar nuk kualifikohen.